



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 31**

Datë: 15.11.2022; Ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Semnai, drejtoreshë u.d., e ZRPPC.

Përkthyesë: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit vendimit të KQZ-së Nr.01/1361/2022, të datës 15.11.2022, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, që do të mbahen më datën 18 dhjetor 2022.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Panit të Buxhetin për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetarë të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, që do të mbahen më datën 18 dhjetor 2022.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit për angazhimin e pesë (5) personave - stafi jo permanent për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin

Potok, dhe Zveçan, pa procedura të rekrutimit (shpalljes), duke angazhuar stafin që ka qenë i angazhuar në procesin e fundit të zgjedhjeve Lokale që janë mbajtur, më 17 tetor 2021.

**6.** Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Lepsaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, që do të mbahen më datën 18 dhjetor 2022.

**7.** Shqyrtimi dhe miratimi i Panit për angazhimin e stafi Jo permanent për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Lepsaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan.

**8.** Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e veriut, Lepsaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

**9.** Formimi i Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e veriut, Lepsaviq, Zubin Potok.

---

**Shpjegim: Kjo mbledhje, është mbajtur përmes shkëmbimit të imellave – komunikimit teknik të anëtarëve të KQZ-së.**

**Burim Ahmetaj, Kryeshef i SKQZ-së, në miellin e tij drejtuar anëtarëve të KQZ-së lidhur me këtë mbledhje të KQZ-së përmes e-mailave, shkruan:**

“Të nderuar, në e-mail gjeni rekomandimet të cilat duhet të votohen nga anëtarët e KQZ-së”.

**Rekomandimet:**

**1.** *Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit vendimit të KQZ-së Nr.01/1361/2022, të datës 15.11.2022, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Lepsaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022.*

**2.** *Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Lepsaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, që do të mbahen më datën 18 dhjetor 2022.*

**3.** *Shqyrtimi dhe miratimi i Panit të Buxhetin për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetarë të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Lepsaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, që do të mbahen më datën 18 dhjetor 2022.*

4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit për angazhimin e pesë (5) personave - stafi jo permanent për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Lepsaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, pa procedura të rekrutimit (shpalljes), duke angazhuar stafin që ka qenë i angazhuar në procesin e fundit të zgjedhjeve Lokale që janë mbajtur, më 17 tetor 2021.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Lepsaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, që do të mbahen më datën 18 dhjetor 2022.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Panit për angazhimin e stafi Jo permanent për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Lepsaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e veriut, Lepsaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

8. Formimi i Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e veriut, Lepsaviq, Zubin Potok.

### **Përmbajtja e imellave të anëtarëve të KQZ-së që janë pjesë e “takimit”, e të ciëlt kanë i kanë votuar këto rekomandime:**

**Kreshnik Radoniqi**, në miellin e tij lidhur me agjendën e mbledhjes, domethënë rreth “shqyrtimit dhe miratimit” të pikave të rekomanduara, shkruan:

“Meqenëse unë kam qenë tërë kohën i konsultuar lidhur me rekomandimet e propozuara për votim, unë nuk kam asgjë për të diskutuar, si dhe duke pas parasysh se çështja është urgjente dhe nuk mund të takohemi fizikisht për mbledhje, unë votoj “Për” miratimin e të gjitha rekomandimeve të propozuara nga Sekretariati – 8 rekomandimet e detajuara...”.

**Rifat Krasniq**, në miellin e tij, shkruan: “Unë votoj për 8 rekomandimet”.

**Ibrahim Selmanaj**, në miellin e tij shkruan: “Duke pasur parasysh kohën e shkurtër dhe arsyen, jam për dhe votoj pro të gjitha propozimeve nga Sekretariati”.

**Sami Kurteshi**, në imellin e tij, shkruan: “ Pas konsultimit të shkurtër të dokumenteve të ofruara për mbledhjen e sotme në lidhje me miratimin e dokumenteve, unë jam në parim Për. Por kam dy çështje për sqarim.

1.Votoj për miratimin e punës jashtë orarit të rregullt, pra unë pajtohem që secili anëtar i stafit të angazhuar për punë jashtë orarit të shënojë kohën e saktë të punës jashtë orarit, si dhe punën e kryer, ashtu siç, e kemi bërë në dy palë zgjedhjet e kaluara, nëpërmjet tabelës së rregulluar nga SKQZ.

2. Meqenëse Presidentja ka shpallur zgjedhje vetëm për kryetar të komunave, si do të bëhet me zgjedhjet për Kuvendet Komunale në komunat ku do të jetë e domosdoshme të mbahen zgjedhjet, nëse nuk ka kandidatë të mjaftueshëm për zëvendësime, siç është paraparë me ligj.

Me sqarimin e këtyre dy çështjeve, unë jam për. Për pikat tjera nuk kam ndonjë sugjerim, pyetje.”

**Sami Hamiti**: “Unë i pash të gjitha materialet! Duke marrë parasysh afatet e shkurtra në këto zgjedhje dhe vendimet të cilat duhet të merren me urgjencë, unë votoj për tetë (8) rekomandimet”.

**Fazli Stollaj**: “Pas marrjes së disa sqarimeve, votoj për të gjitha rekomandimet”.

**Gordana Llaban**: “ Të nderuar kolegë! Pajtohem me të gjitha propozimet dhe votoj për aprovimin e të gjitha rekomandimeve”.

**Alim Rama**: “Dokumentet e dërguara nga Sekretariati nuk i kanë kaluar filtrat e këshillave dhe nuk janë analizuar si duhet, si dhe rrethanat në terren. Kjo vlen për afatet, buxhetin dhe planin operacional.

Disa shembuj: Data e certifikimit të subjekteve/kandidatëve është 26 nëntor, ndërsa fillimi i fushatës është caktuar më 8 dhjetor. Data e caktuar për fillimin e fushatës, është në kundërshtim me rekomandimet e BE dhe pajtimit gjatë shqyrtimit të rregulloreve ku jemi pajtuar që fushata fillon me ditën e certifikimit, që është 26 nëntor.

Plani dhe buxheti për stafin jo permanent nuk merr parasysh zgjedhje tani për tani janë caktuar vetëm për kryetar të komunave ku në zgjedhjet e fundit lokale kanë qenë 9 në katër komuna, tash edhe nëse pesëfishohen nuk kalon 45. Ndërsa numri i votuesve para një viti ishte vetëm 43750 në të katër komuna, sa gjysma e Podujevës.

Prandaj, unë votoj kundër propozimeve dhe kërkoj të rishqyrtohen sipas rrethanave në terren”.

**Konstatim**: Për kanë votuar shtatë (7 anëtarë), kundër një ( 1 ) anëtarë. ( Alim Rama).

2. Në bazë të rekomandimit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP), rekomandon Këshillit të Operacioneve Zgjedhore, shterjen e afateve sipas pikave vijuese, nga anëtarët e KQZ-së janë miratuar afatet:

- a) *Afati për aplikim për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje të shtyhet nga 21 nëntor deri më 25 nëntor 2022;*
- b) *Afati për paraqitjen e përmirësimeve/korrigjimeve nga subjekteve politike të shtyhet prej 26 nëntor deri në 28 nëntor 2022;*
- c) *Afati për vendimmarrjen e KQZ-së për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të shtyhet prej 26 nëntor deri më 28 nëntor 2022;*
- d) *Afati për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve politike të shtohet prej 27 nëntor deri më 28 nëntor 2022.*
- e) *Afati për Emërimin e KKZ-ve shtyhet prej 24 nëntor deri me datën 28 nëntor 2022.*

3. Rekomandim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të KQZ-së Nr.01/1362/2022, të datës 15.11.2022, për miratimin e planit operacional për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen më datë 18 dhjetor 2022:

Afati për miratimin e Planit Operacional të Sigurisë, shtyhet deri me datën 25 nëntor 2022.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i panit të buxhetin për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetarë të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, që do të mbahen më datën 18 dhjetor 2022:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zbatimin e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së për zgjedhjet të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan, që do të mbahen më datën 18 dhjetor 2022:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit për angazhimin e stafit jo permanent:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan:

8. Formimi i Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e veriut, Leposaviq, Zubin Potok: